

VENDIM
Nr. 167, datë 19.7.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DERBI-E”
SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË NGA HEC “ANTENA”,
ME FUQI TË INSTALUAR 1105 kw**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.7.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “DERBI-E” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Antena”, me fuqi të instaluar 1105 kw,

konstatoi se:

Shoqëria “DERBI-E” sh.p.k., me shkresën nr. 69 prot., datë 11.7.2018, protokolluar në ERE me nr. 503 prot., datë 11.7.2018, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Antena”, me fuqi të instaluar 1105 kw, për një periudhë 49-vjeçare.

Aplikimi i shoqërisë “DERBI-E” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3; gjerat “a”, “b”, “c”, “d”; 4.1.4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; 4.1.5, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Vërtetim nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ta paraqesë atë në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “DERBI-E” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Antena”, me fuqi të instaluar 1105 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti